



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 10224/2022
Data: 14.12.2022

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2022 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 23.11.2022 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Prezent ishte **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport). Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Takim dhe bashkëpunim me drejtorët e komunës.
3. Diskutim rreth përmbushjes së planit vjetor të punës së këtij komiteti.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim dhe bashkëpunim me drejtorët e komunës.

Kryesuesi thekson:- në diskutime me qytetarët të cilat i kam potencojnë se gjoja në Han të Elezit shtatëdhjetë përçin udhëhiqet jo prej udhëheqësve të cilët janë enkas për me udhëhequr komunën por prej zyrtarëve të tjerë që do të thotë pse a e zyrtarëve të cilët e përbëjnë shtatëdhjetë përqindëshin nuk bien vendime por menaxhojnë në marrje të vendimeve dhe vazhdimisht rrinë në telefona dhe me mesazhe se çka është duke u bërë në komunë e që mu nuk më pëlqen e që i bien që komuna është e ndarë në dy pjesë dhe qytetarët e dinë këtë. Kam dëgjuar që një anshëm është shkëputur kontrata kolektive e mes të MASHT-it dhe sindikatës.

Hisni Luri thekson:- e kemi diskutuar me asociacionin e komunave që me bërë një far lloj presioni te Ministria e Arsimit. Në vitin 2021 e kanë përsëritur kontratën kolektive dhe pas disa muajve me shkëputur kompletë dhe neve si komunë na largon prej përgjegjësive që me paguar obligimet që i kemi pre kontratës kolektive por në anën tjetër është e dëmshme për mësimdhënësit e drejtorët dhe stafin e shkollës që do të thotë më shumë është një tendencë politike se sa një vendim i përpunuar mirë.

Kryesuesi thekson:- a ka mjek bollë në QKMF dhe si është gjendja në QKMF . Si është gjendja me çështja e barnave. Si janë mardhëniet ndërnjerëzore në kolektiv. Si është sjellja e mjekësve me pacientë. Kur është miratuar rregullorja për taksa dhe tarifa.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:- problem kemi me mjek familjarë sepse në tërë Kosovën janë në mungesë por edhe në Han të Elezit. Problem kemi me staf sepse nuk është i mjaftueshëm për me i përmbushur të gjitha ato shërbime të cilat i kemi. Ky problem është që nga vitin 2009 kur ka filluar sektori i emergjencës që automatikisht 4 mjek me 8 infermier barten me ndërrim të natës dhe mjekësia familjare mbetet vetëm me dy mjekë dhe pesë infermierë , nuk i mbulon nevojat të cilat janë të përcaktuara me statut të QKMF-së . Kërkesë kemi bërë vazhdimisht në Ministrinë përkatëse për këtë çështje por nuk kemi pranuar përgjigje. Ministria e ka paraparë një grandë specifike që me një numër prej 300 mjekëve me i mbuluar krejt qendrat e Kosovës , mirëpo për vitin 2023 për Han të Elezit nuk është paraparë asnjë mjek por me stafin të cilin e kemi jemi duke u mundur me u kryer shërbimet. Për çështje të barnave kemi problem me furnizim me barna esenciale kemi në mungesë por kemi lidhur kontratë me një kompani që në momentin që mungojnë barna prej listës esenciale me na furnizuar kompania. Edukatën për sjellje nuk mundemi me ja dhënë askujt por varet prej etikës njerëzore që e kanë por kam bërë apel edhe te qytetarët se nëse keni vërejtje kutia e ankesave ekziston dhe është mirë me parashtruar ankesë pastaj janë edhe masat ndëshkuese.

Zaim Bela thekson:- sa ka mundur me i vjelë taksat drejtoria për zhvillim ekonomik prej bizneseve.

Resul Suma thekson:- a kanë borxhe bizneset ndaj komunës.

Majlinda Kaloshi thekson:- është miratuar në kuvend dhe është përcjell për në Ministri të Administrimit të Pushtetit Lokal. Bizneset kanë borxhe ndaj komunës dhe kemi filluar me letër kujtesa dhe kemi pasur edhe marrëveshje që kemi bërë por ka pasur suksese.

Kryesuesi thekson:- kompania Telkos çmimet i ka rritur për internet dhe kabllovik dhe me që RTK-ja është e shtetit dhe është publike por kur të kalon afati i pagesës mujore mos me nja ndërprerë RTK-në për shkak se ka raste që qytetarët nuk kanë mjete për me një herë me bërë pagesë.

Majlinda Kaloshi thekson:- sa i përket çmimeve që i ka ngritur kompania Telkos është problem me ndikuar për shkak se është kompani private dhe i ka politikat e veta. Unë ju sugjeroj si komitet më bërë një kërkesë dhe mi paraqitur shqetësimet e komunitet dhe me ja dërguar kompanisë Telkos

Resul Suma thekson:- i kemi paraqitur ankesat e qytetarëve te kompania Telkos por arsyeja e tij ka qenë sepse janë rritur çmimet në tërë Kosovës edhe për internet edhe kabllovik.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Diskutim rreth përmbushjes së planit vjetor të punës së këtij komiteti.

Kryesuesi thekson:- i kemi mbajtur të gjitha mbledhje deri më tani dhe askush nga anëtarët nuk ka munguar. Në mbledhje kanë munguar drejtorët për resorët adekuatë dhe kemi mbetur me një hapësirë të ngushtë të informimit. Unë mendoj se e kemi realizuar planin. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- mbledhjet i kemi mbajtur të rregullta dhe i kemi diskutuar të gjitha pikat të cilat janë paraparë në planin e punës.

Kryesuesi thekson:- duhet ta bëjmë planin e punës për vitin 2023 dhe ju si anëtarë të komitetit është mirë që të përzgjidhni ndonjë pikë për me diskutuar që i përket këtij komiteti. Pikat që ju mendoni me i diskutuar për vitin 2023 mi dërgoni në imell adresë sepse për mbledhje të dhjetorit duhet të miratohet në kuvend në mënyrë që me filluar në vitin 2023 me plan të punës. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoj në 15:07.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

